



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 50.
Prishtinë, më 25.09.2012 në ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

Mungon: Elmi Reçica

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB, Elita Vokshi, Lejla Selimi, Shpend Qamili, përfaqësuese të zyrës së EULEX Visar Bivolaku përfaqësuese të zyrës së KDI-së Florije Mehmeti, përfaqësuese të zyrës së IND-së Visar Bikliqi, përfaqësues të zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Kordinatore - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-86 për Parkun Kombëtar ‘Bjeshkët e Nemuna’, me raportin e Komisionit, funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-87 për Parkun Kombëtar ‘Sharri’ , me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor , me amendamente.**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e konsumatorit, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amandamante**

5. **Shqyrtimi i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, me amendamente.**
6. **Të ndryshme**

Kryesuesi – konsideron se në fillimin e mbledhjes së sotëm nuk janë plotësuar kushtet, për arsye të mungesës së pajisjeve për përkthim andaj kërkoi që administrata për mbështetje të komisionit ti drejtohet me shkresë sekretarit të Kuvendit, që në të ardhmen të evitohet ky problem.

Kryesuesi , hapi mbledhjen me këtë pikë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-86 për Parkun Kombëtar ‘Bjeshkët e Nemuna’, me raportin e Komisionit, funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-86 për Parkun Kombëtar ‘Bjeshkët e Nemuna’ të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t’i dërgohet Komisionit Funksional.

Me që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri , nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-86 për Parkun Kombëtar ‘Bjeshkët e Nemuna’ dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- #### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-87 për Parkun Kombëtar ‘Sharri’ , me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor , me amendamente**

Kryesuesi, - informoi komisionin se me kërkesë të anëtarit të komunitetit goran z. Musresl Halili, i cili ka shpreh shqetësimin e tij se Parku Kombëtar ‘Shari’ për arsye të afërsisë mund të cenojë pjesën rurale për ardhmërinë e qytetarëve në këtë rajon.

Rasim Demiri –sa i përket Parkut Nacional ‘Sharri’ ka ekzistuar gjithmonë dhe mund të thuhet se me ligj këtë ligj ky territor është zgjeruar për 22 hektar, Mirëpo qytetarët brengosen nga se nuk kanë njohuri të duhur dhe shtoi se me këtë ligj nuk do të mohohet apo cenohet pronësia private e ndonjë qytetari.

Ajo që konsiderohet e rëndësishme është se Ligji për Parkun Kombëtar ‘Sharri’ i parasheh tri zona andaj theksoi se me këtë ligj nuk mohohet e drejta për shfrytëzimin e kësaj zone.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-87 për Parkun Kombëtar ‘Sharri’ dhe njëzëri, nxori këtë.

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-87 për Parkun Kombëtar ‘Sharri’ dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e konsumatorit, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente.**

Komisioni shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e konsumatorit dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e konsumatorit dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, me amendamente.**

Komisioni shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme.

Kryesuesi - theksoi se në bazë të procedurave të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për realizimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012, si detyrë e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka mbetur realizimi i vizitës të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian, në zonën e Mitrovicës ku niveli i kontaminimit me plumb është shumë i lartë.

Në këtë drejtim, Komisioni ka formuar grupin punues, i udhëhequr nga Albert Kinolli, ku si detyrë ka mbikëqyrjen e gjendjes shëndetësore të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian, të Mitrovicës.

Albert Kinolli, tha se në kuadër të procedurave parlamentare të bazuara në Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, të procedurave të propozuara për Komision sipas pikës: 141 dhe 143, si rezultati i punës është realizimi i vizitës për komunitetet Rom, Ashkalij dhe Egjiptian në Mitrovicë, zonë e cila është e kontaminuar me plumb.

Ai shprehu shqetësimin e tij se Qeveria që trembëdhjetë vite nuk ka ndërmarr asnjë veprim në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të këtyre komuniteteve.

E informoi komisionin se grupi punues, me datën 17.09.2012, iu është drejtuar me shkresë Ministrisë së Shëndetësisë që të dërgojë Raportin, me qëllim të informimit me gjendjen shëndetësore të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Mitrovicës dhe shtoi se për komision deri sot nuk është marrë asnjë përgjigje.

Ky proces kërkon të llobohet në ministrinë përkatëse në prezantimin e raportit të lartcekur, ku më pas do të arrihet të bëhet krahasimi i situatës në terren.

Lirije Kajtazi – në fjalinë e saj tha se komisioni është në periudhën e monitorimit të gjendjes shëndetësore të komunitetit Romë Ashkalinjë dhe Egjiptian në zonën e Mitrovicës, ndërsa në mungesë të raportit të Ministrisë së Shëndetësisë ajo propozoi që të kërkohej një raport nga qendra më afër - sektori familjar, i cili raport do të ndihmojë për të parë gjendjen reale të këtyre komuniteteve.

Xhevdet Neziraj – sa i përket realizimit të vizitës ishte i mendimit që fillimisht komisioni të kërkojë raportin me shkrim nga Ministria e Shëndetësisë, nga se nuk mund të dilet me pasqyrë krahasuese për gjendjen shëndetësore të qytetarëve të cilët jetojnë në kampin e zonës së Mitrovicës.

Propozimi i tij ishte që gjatë vizitës të jenë prezent edhe përfaqësuesit e ministrisë përkatëse, të cilët do të vlerësojnë gjendja faktike të këtyre komuniteteve.

Pas realizimit të vizitës, Komisioni do të dalë me rekomandime konkrete, për realizimin dhe mbrojtjen e interesave të komuniteteve jo shumicë

Glauc Konjufca – theksoi se në bazë të raportit të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, e cila ndërlidhet me gjendjen shëndetësore të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian, për 13 vite është çështje e pazgjidhur nga institucionet qeveritare.

Njëherit pajtohet me parafolësit të mos përgjigjemi ftesës për vizitë në zonën e Mitrovicës, nga se fillimisht duhet të bëhet nisma e procesit i cili do të kurorëzohet me një zgjidhje konkrete.

Ai propozoi që komisioni të dërgojë mocion për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës, me rekomandime konkrete, ku Qeveria do të obligohet në përmbushjen e përgjegjësiave në zgjedhjen e çështjes faktike të këtyre komuniteteve.

Dhe si alternativë e dytë, propozoi të ftohet Ministri i Shëndetësisë që të prezantojë raportin për gjendjen shëndetësore të komunitetit Romë Ashkalinjë dhe Egjiptian.

Kryesuesi – propozimi i tij ishte që në mbledhjen e ardhme në komision të ftohet ministri i Shëndetësisë, me arsyetim që të raportohet për gjendjen shëndetësore të Komunitetit në fjalë. Më pas grupi punues do të vizitojë zonën e Mitrovicës dhe në bazë të vlerësimeve të përgjithshme Komisioni do të dalë me rekomandime konkrete për Kuvend.

Pas diskutimeve dhe sugjerimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

Në mbledhjen e radhës, më datën 2.10.2012, në ora 11,00, të ftohet Ministri i Shëndetësisë me arsye të raportojë për gjendjen shëndetësore të Komuniteteve Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptian të Mitrovicës, në zonën e kontaminuar me plumb.

Në bazë të vlerësimeve të përgjithshme komisioni do të dal me raport me rekomandime për Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic